# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5413
E enjte, 1 mars 2018
çmimi 0.40 €



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## PRESIDENTI I PËRBASHKËT

FAQE 11



Rexhep QOSJA


AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


JEAN-CLAUDE JUNCKER, FEDERICA MOGHERINI DHE JOHANNES HAHNI KANË VIZITUAR KOSOVËN FAQE 4-5

# Junckeri: Demarkacioni, hap kyç drejt liberalizimit të vizave



Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, ka bërë të qartë se ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi është një hap kyç dhe i pashmangshëm drejt liberalizimit të vizave për Kosovën. Pas takimit me liderët politikë të Kosovës në Prishtinë, ai është zotuar se Komisioni Evropian do ta rekomandojë liberalizmin e vizave për qytetarët e Kosovës nëse ratifikohet demarkacioni me Malin e Zi. I pari i Komisionit Evropian ka pranuar se nuk është e drejtë që qytetarët e Kosovës janë të vetmit në Evropë që nuk mund të udhëtojnë lirshëm. Në këtë vizitë zyrtarët e lartë të BE-së kanë bërë thirrje që Kosova ta luftojë edhe korrupsionin

# Mungesa e votave shtynë sërish votimin e demarkacionit

Kuvendi i Kosovës ka shtyrë sërish votimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Deri te shtyrja erdhi sërish për shkak të mungesës së votave të mjaftueshme për ratifikimin e kësaj marrëveshje. Vazhdimi i seancës për demarkacionin pritet të mbahet javën e ardhshme



## Liderët: Historia e re e Kosovës i ka rrënjët në Likoshan e Çirez

Në nderim të sakrificës së dëshmorëve dhe martirëve të Likoshanit e të Çirezit, të mërkurën është mbajtur akademi përkujtimore, në të cilën është vlerësuar lart kontributi i të rënëve për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Në 20-vjetorin e kësaj masakre drejtuesit e shtetit kanë thënë se Drenica ndër shekuj ka qenë vatër e kryengritjes FAQE 7

## AKTUALE

### PREKAZI, NJË KRIM SERB I SHEKULLIT F. 13

Basri MUSMURATI



### NUK DO TË KETË MËSIM DERI NË JAVËN E ARDHSHME F. 3

### AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM PËRJASHTOHET NGA EQAR-ja F. 6

## EKONOMI

### FORUMI I PARË EKONOMIK NDËRMJET KOSOVËS DHE DANIMARKËS MBAHET NË QERSHOR F. 9

### ÇMIMET E INPUTEVE BUJQËSORE SHËNOJNË RËNIE PËR 2.8 PËR QIND F. 8

## KULTURË

### ARTISTËT INICIOJNË AKTIVITETE PËR TA NDIHMUAR REGJISORIN BEKIM LUMI F. 13



## SPORT

### PJESËMARRJA NË 'PYEONGCHANG 2018', E SUKSESSHME F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
SatStyro
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Presidenti Meta, i gatshëm të shkojë në Parlament për negociatat me Greqinë

Pas kërkesës së opozitës për seancë dëgjimore me presidentin Ilir Meta, ka reaguar Presidenca, duke thënë se presidenti Ilir Meta është gati të shkojë në Parlament dhe të përgjigjet para deputetëve



Tiranë, 28 shkurt - Deputetët e opozitës në Komisionin e Jashtëm kërkuan seancë dëgjimore me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta, në lidhje me negociatat me Greqinë. Kërkesa u artikulua nga deputeti demokrat Tritan Shehu, i cili tha se në emër të PD-së do të depozitojë me shkrim këtë kërkesë. "Unë nuk mund të mos ta nis fjalën time duke jua tërhequr vëmendjen për shkelje të rëndë të etikës që ju treguat gjatë fjalës suaj ndaj anëtarëve të komisionit, ndaj presidentit të Republikës, duke përdorur terma të papajtueshme ndaj këtyre institucioneve thelbësore. Duke marrë shkas nga kjo gjë unë do ta bëj kërkesën në emër të deputetëve të opozitës që, pas kësaj mbledhje, në një ditë të përshtatshme, të organizojmë një mbledhje të dytë dhe të thërrasim këtu për një seancë dëgjimore presidentin. Ne do ta paraqesim edhe me shkrim këtë kërkesë dhe kërkojmë që këtu të vijë edhe presidenti i republikës. U bënë shumë lojëra fjalësh mbi të, shumë akuza mbi të, ato probleme ju ministër t'i zgjidhi me presidentin. Ne nuk na intereson sa herë ka shkuar ministri në Presidencë", u shpreh Tritan Shehu.

Dhe pak minuta pas kësaj deklarate ka ardhur reagimi i Presidencës, e cila konfirmon gatishmërinë e kreut të Shtetit për t'u paraqitur në Kuvend dhe për t'i sqaruar ligjvënësit lidhur me procesin e negociatave që po zhvillohen me Greqinë për çështjen e detit, si dhe për ta sqaruar komunikimin institucional mes Qeverisë dhe presidentit për këtë çështje. Zëdhënësi i presidentit, Tedi Blushi, tha se presidenti Ilir Meta është gati të shkojë në çdo kohë në Parlament kur ta kërkojë Komisioni i Jashtëm. "Presidenti Ilir Meta është gati të shkojë në Parlament dhe të përgjigjet para deputetëve", thuhet në përgjigjen e Presidencës.

## Bushati: Presidenti ka qenë në dijeni për negociatat me Greqinë

Tiranë, 28 shkurt - Një ditë pas publikimit të emrave të 12 negociatorëve të marrëveshjes së detit me Greqinë, kryetarja e komisionit të politikës së Jashtme, Mimi Kodheli, ka thërritur në seancë dëgjimore në komision ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati.
Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, tha se presidenti Meta ka qenë në dijeni të negociatave me Greqinë qëkur ai ishte në krye të Kuvendit. "Pas takimit të kryeministrit Rama dhe Tsipras në samitin e NATO-s u ra dakord që, krahas mekanizmit diplomatik, dy ministrat e jashtëm, së bashku me ekipe nga institucione të ndryshme të shteteve në fjalë, të uleshin dhe të diskutonin në një mënyrë edhe më intensive siç ishin takimet e Kretës dhe Korçës.
Gjatë mbledhjes së komisionit, Bushati e etiketoi presidentin me fjalët "i shkreti", ndërsa ironizoi se nuk mund t'i jepte zgjidhje tri çështjeve "ego, paranoja dhe Saliu", një shprehje të përdorur disa kohë më parë nga Edi Rama për Ilir Metën.

LAJME SHKURT

### Xhaferi: Opozita së shpejti mund të kthehet në Kuvend

Shkup, 28 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, në ditët në vijim pret të gjendet zgjidhje për mbi 35 mijë amendamentet e Ligjit për përdorimi e gjuhëve të parashtruara nga VMRO-DMNE opozitare. "Komunikoj me përfaqësues të grupeve të deputetëve duke e përfshirë edhe VMRO-DPMNE-në. Mendoj se jemi afër zgjidhjes", tha Xhaferi në takimin e së mërkurës me gazetarët në Kuvend. I pyetur nëse zgjidhje do të ishte të debatohet për amendamentet e VMRO-DPMNE-së, Xhaferi tha se hapja e debatit për to do të thoshte bllokadë të punës së Kuvendit. Qëllimi, siç theksoi ai, është të shmanget bllokada e Kuvendit. Në mënyrë procedurale, siç tha, ai nuk do të lejojë të ndodhë bllokadë në shtëpinë ligjdhënëse. "Për Ligjin për gjuhët është biseduar edhe në takimet me tre eurodeputetët Ivo Vajgëll, Knut Flekenjstajn dhe Eduard Kukan, të cilët janë nismëtarë në bisedimet në suaza të procesit Zhan Mone. Takimi i parë me përfaqësuesit e partive parlamentare, përfshirë edhe VMRO-DPMNE-në, pritet të mbahet më 15 mars, por nëse nuk sigurohet prania e eurokomisarit Jonanes Han dhe të ekspertëve, bisedimet do të mund të shtyhen për në maj. Tema në këto bisedime do të jenë ndryshimet në Rregulloren për Punën e Parlamentit dhe Kodi Etik, por grupet parlamentare mund të dorëzojnë edhe propozime të tyre të cilat do të vendosen në tryezë", tha ai.
Xhaferi konsideron se së shpejti opozita do të mund të kyçet sërish në punën e Kuvendit. Duke i pasur parasysh paraburgimet e deputetëve dhe persona të tjerë lidhur me dhunën në Kuvend më 27 prill dhe procedura që zhvillohet para institucioneve, Xhaferi konsideron se për një kohë të shkurtër dhe në atë bazë do të ndërpriten argumentet për nevojën e VMRO-DPMNE-së të jenë jashtë Kuvendit.

### Jared Kushneri humbet të drejtën për informacionet tepër sekrete

Uashington, 28 shkurt - Dhëndri i presidentit Donald Trump, Jared Kushner, i cili është njëkohësisht një prej këshilltarëve të tij kryesorë, ka humbur të drejtën për t'u njohur me informacionet tepër sekret të agjencive të zbulimit, që i jepen përditë presidentit, gjatë të ashtuquajturit "Informimi ditor i presidentit". Gazeta "The Washington Post" shkruan se kontaktet e Kushnerit me disa zyrtarë të lartë të huaj kanë ngritur shqetësime brenda Shtëpisë së Bardhë. Sipas gazetës, zyrtarë të të paktën katër vendeve kanë diskutuar privatisht se si t'i shfrytëzojnë bizneset e tij, vështirësitë financiare, apo mungesën e përvojës në politikën e jashtme, për ta manipuluar atë. Gazeta i identifikon këto vende si Emiratet e Bashkuara Arabe, Kina, Izraeli dhe Meksika.
Jared Kushner është bashkëshorti i vajzës së madhe të presidentit, Ivanka. Presidenti ka aftësinë t'ia japë Kushnerit të drejtën e përhershme për t'u njohur me informacione sekrete të agjencive të zbulimit, por ai tha se do t'ia delegojë përgjegjësinë shefit të personelit të Shtëpisë së Bardhë, John Kelly.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Mungesa e votave shtynë sërish votimin e demarkacionit



Kuvendi i Kosovës ka shtyrë sërish votimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Deri te shtyrja ka ardhur sërish për shkak të mungesës së votave të mjaftueshme për ratifikimin e kësaj marrëveshje. Vazhdimi i seancës për demarkacionin pritet të mbahet javën e ardhshme

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHKURT - Me pajtim të kryetarëve të grupeve parlamentare, seanca e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën ishte paraparë të votohej marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi, është shtyrë për një ditë tjetër. "Për vazhdimin e seancës do të vendosë Kryesia e Kuvendit", është thënë në njoftimin për medie të Zyrës për Informim të Kuvendit.

Burime të gazetës "Epoka e re" brenda grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë bërë me dije se seanca për demarkacionin do të mbahet në javën e ardhshme. Pavarësisht prej arritjes së një marrëveshje mes partive në pushtet dhe partisë në opozitë, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së), ende nuk janë siguruar 2/3 e votave për ta ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi.

Javën e kaluar, Kuvendi, në dy raste ka provuar ta ratifikojë marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, por nuk arriti ta përmbyllë seancën me votim, ngaqë nuk ishin siguruar 80 votat e domosdoshme për kalimin e kësaj marrëveshje.

Kryeministri Ramush Haradinaj të mërkurën ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e Listës Serbe, e cila është pjesë e koalicionit qeverisës, për të kërkuar nga ajo votën për demarkacionin. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli. Po ashtu, koalicionit qeverisës të mërkurën i kanë munguar edhe katër deputetë dhe dy deputetë të LDK-së, të cilët kanë qenë për vizitë në Mal të Zi.

Në seancën e së mërkurës shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka prezantuar marrëveshjen e arritur me partitë e koalicionit në pushtet, përfshirë minoritetet joserbe. Pas votimit, në favor të shmangies procedurale të paraparë me Rregulloren e Kuvendit, kryeparlamentari Veseli ka kërkuar pauzë në seancë, me qëllim që shefat e grupeve parlamentare t'i harmonizojnë qëndrimet për projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi, i cili më pas do të nxirret në votim para deputetëve.

Ndërkaq, Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme me shumicë votash ka votuar në favor të plotësimit të Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Projektligji i plotësuar, pas harmonizimit të partive shqiptare në pushtet dhe asaj opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës, do të nxirret për votim para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka paralajmëruar se në aspektin kohor, mund të shtyhet seanca për votimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. "Mund të ndodhë të shtyhet seanca nëse e kalkulojmë në aspektin kohor sepse disa deputetë shqiptarë janë në Podgoricë", ka thënë Haradinaj.

Javën e kaluar partitë e koalicionit qeverisës, PDK-ja, AAK-ja, Nisma Socialdemokrate, AKR-ja dhe partia opozitare - LDK-ja, arritën një marrëveshje, por ajo ende nuk i ka siguruar dy të tretat, apo 80 votat e nevojshme për ratifikimin e demarkacionit.

Aktualisht subjekti opozitar, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe, nuk po e mbështesin ratifikimin e demarkacionit. Sipas matematikave të tashme, janë rreth 78 vota të deputetëve në favor të demarkacionit.

Përfaqësuesit ndërkombëtarë javët e fundit u kanë adresuar deputetëve dhe institucioneve të Kosovës disa herë thirrje ta kalojnë demarkacionin dhe ta nxjerrin vendin nga izolimi.

Shqetësimet e ndërkombëtarëve ndërlidhen me faktin se, pavarësisht prej një marrëveshje që partitë e koalicionit kanë me një pjesë të opozitës, ende nuk janë siguruar votat e nevojshme për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacion.

Çështja e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje po zgjatë që nga viti 2015, kur Prishtina dhe Podgorica e kishin nënshkruar atë në Vjenë.

Kuvendi i Malit të Zi e ka ratifikuar tashmë marrëveshjen, por jo edhe ai i Kosovës për shkak të mungesës së konsensusit të brendshëm politik. Dështimi eventual i ratifikimit të marrëveshjes nga Kuvendi i Kosovës besohet se do të krijonte pasoja të mëdha politike për Kosovën qoftë për nga dështimi i marrëveshjes me Malin e Zi apo edhe me humbjen e rastit për liberalizimin e vizave, ngaqë ratifikimi mbetet kusht i Bashkimit Evropian për hapjen e perspektivës për qytetarët e Kosovës për lëvizjen e lirë, pa viza.

## Nuk do të ketë mësim deri në javën e ardhshme



PRISHTINË, 28 SHKURT - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim të vazhdohet ndërprerja e mësimit në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar edhe më 1 mars dhe 2 mars. "Ky vendim është marrë pas mbledhjes së raporteve për gjendjen e krijuar nga temperaturat e ftohta nëpër komuna dhe në konsultim me drejtoritë komunale të arsimit, si dhe duke pasur parasysh të dhënat që dalin nga Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës. Ditët e humbura të mësimit do të zëvendësohen gjatë këtij gjysmëvjetori në konsultim me drejtoritë komunale të arsimit", është thënë në njoftimin e MAShT-it.

Jean-Claude Juncker, Federica Mogherini dhe Johannes Hahn kanë vizituar Kosovën

# Junckeri: Demarkacioni, hap kyç drejt

**Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, ka bërë të qartë se ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi është një hap kyç dhe i pashmangshëm drejt liberalizimit të vizave për Kosovën. Pas takimit me liderët politikë të Kosovës në Prishtinë, ai është zotuar se Komisioni Evropian do ta rekomandojë liberalizmin e vizave për qytetarët e Kosovës nëse ratifikohet demarkacioni me Malin e Zi. I pari i Komisionit Evropian ka pranuar se nuk është e drejtë që qytetarët e Kosovës janë të vetmit në Evropë që nuk mund të udhëtojnë lirshëm. Në këtë vizitë zyrtarët e lartë të BE-së kanë bërë thirrje që Kosova ta luftojë edhe korrupsionin**



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 SHKURT - Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, ua ka rikujtuar edhe një herë liderëve politikë të Kosovës rëndësinë e ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi. Pas takimit me liderët politikë të vendit, në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin Hashim Thaçi, i pari i Komisionit Evropian ka thënë se ratifikimi i kësaj marrëveshje është një hap kyç, i pashmangshëm dhe i rëndësishëm drejt liberalizimit të vizave. "Është esenciale që Kuvendi juaj ta votojë së shpejti demarkacionin e kufirit të përbashkët me Malin e Zi. Është një hap kyç, i pashmangshëm, i rëndësishëm drejt liberalizimit të vizave, ku bashkëqytetarët tuaj shqiptarë e serbë do të jenë përfituesit e parë", ka thënë ai.

Junckeri ka bërë me dije se pas ratifikimit të demarkacionit, Komisioni Evropian do ta rekomandojë liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Po ashtu, numri një i KE-së ka porositur liderët politikë t'i thellojnë edhe më tej përpjekjet për luftimin e korrupsionit. Ai ka thënë se nuk është fare i kënaqur që kosovarët janë të vetmit qytetarë në Evropë që nuk mund të udhëtojnë lirshëm. "Nuk më kënaq ideja që kosovarët janë të vetmit në rajon dhe në Evropë që nuk mund të udhëtojnë lirshëm. Ata janë qytetarë si të tjerët dhe duhet t'i kenë të njëjtat të drejta, me kusht që demarkacioni të zgjidhet. Gjithashtu, të arrihen edhe hapa konkretë në luftën kundër trafiqeve, në luftën kudër korrupsionit", është shprehur Junckeri.

I pyetur nëse ka një datë të saktë të liberalizimit të vizave nëse Kosova voton demarkacionin me Malin e Zi, Junckeri ka thënë se nuk varet nga BE-ja përcaktimi i datës. "Nuk kam ardhur këtu të ligjëroj për demokracinë. Nuk varet nga ne që t'i themi Kosovës kur dhe si do të bëhet kjo. Kjo është demokraci e të rriturve dhe nuk mund t'ju jap ndonjë datë", ka thënë Junckeri. Duke folur për strategjinë e re të zgjerimit të BE-së të publikuar në muajin shkurt, Junckeri ka thënë se ajo mbulon gjithë Ballkanin Perëndimor dhe kërkon ta thellojë bashkëpunimin me të gjithë partnerët e rajonit, duke përfshirë edhe Kosovën.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka siguruar kreun e KE-së që Kuvendi i Kosovës shumë shpejt do ta ratifikojë demarkacionin me Malin e Zi. Sipas tij, kjo është një çështje tepër emergjente në rrugën evropiane drejt Kosovës. "Besoj se të gjithë e kemi të qartë se pse sot Kuvendi i Kosovës nuk arriti ta ratifikojë marrëveshjen për kufirin me Malin e Zi. Nuk do të komentoj këtu asgjë, sepse jam i bindur se marrëveshja do të ratifikohet në ditët e ardhshme. Dhe në momentin që kjo të ndodhë, unë jam i bindur se presidenti Juncker, të gjithë bartësit e institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian, do ta bëjnë punën e tyre, do t'i marrin vendimet e tyre të duhura dhe do t'i japin fund izolimit të qytetarëve të Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi.

### Kosova dhe Serbia duhet të gjejnë pajtim

Në takimin e liderëve politikë të Kosovës me presidentin e KE-së, Jean-Claude Juncker, përfaqësuesen e lartë të BE-së, Federica Mogherini, si dhe komisionarin Johannes Hahn, është biseduar edhe për procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Presidenti Juncker ka thënë se BE-ja dëshiron që kosovarët dhe serbët të gjejnë një pajtim mes vete. "Ne duam që marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë të vihen në një bazë të re. Është themelore që kosovarët dhe serbët të gjejnë një pajtim mes vete, e cila do të jetë juridikisht detyruese për të ecur së bashku drejt Evropës", ka thënë ai.

Kurse presidenti Thaçi ka thënë se Kosova është e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë. Thaçi ka theksuar se prania e delegacionit më të lartë të Bashkimit Evropian në Kosovë është dëshmi e qartë e përkushtimit të rritur të BE-së për Kosovën dhe për të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Sipas tij, strategjia e re e zgjerimit ka rikonfimuar dy gjëra tepër të






# liberalizimit të vizave



rëndësishme. Së pari, ka thënë Thaçi, ka konfirmuar të ardhmen e sigurt për anëtarësimin e Kosovës në BE, ashtu siç e ka bërë edhe për të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Së dyti, sipas presidentit Thaçi, kjo perspektivë e anëtarësimit në BE është e kushtëzuar me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese ndërshtetërore ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor. "Kosova është plotësisht e përkushtuar ndaj këtyre dy qëllimeve dhe detyra jonë është që si hap të parë ta sigurojmë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE dhe natyrisht, të punojmë me përkushtimin më të lartë për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë, në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja përmes një marrëveshjeje përfundimtare", ka thënë Thaçi. Delegacioni i lartë i BE-së ka qëndruar në Kosovë në kuadër të turneut që po zhvillojnë nëpër vendet e Ballkanit Perëndimor.

### Zyrtarët e lartë të BE-së bëjnë thirrje që të luftohet korrupsioni

Zyrtarët e lartë të BE-së, gjatë qëndrimit në Kosovë, kanë zhvilluar edhe një bashkëbisedim të hapur me shoqërinë civile, përfaqësuesit e medieve dhe përfaqësuesit e subjekteve politike në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.
Kryetari i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, me këtë rast ka dhënë porosi të qartë për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Përderisa ka korrupsion dhe krim të organizuar asgjë e mirë nuk do të ndodhë", ka thënë Junckeri. Kurse përfaqësuesja e lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe çështje të sigurisë, Federica Mogherini, ka folur për raportet Kosovë - Serbi. "Unë shoh vendosmërinë, vullnetin në të dyja palët për një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme. T'i lëmë vetëm palët të vendosin për konsensusin e tyre. Jam optimiste për një përfundim të mirë", ka thënë Mogherini.
Komisionari për zgjerim, Johannes Hahn, ka përsëritur edhe një herë se në BE nuk mund të hyjë askush që ka probleme me fqinjët. "Nuk do të pranojmë asnjë anëtar të ri në BE që nuk i ka zgjidhur kontestet territoriale e të tjera. Pra, është e rëndësishme që në mes të Serbisë dhe Kosovës të ketë një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme", është shprehur Hahn.





# Kryeprokurori i Speciales është larguar nga pozita si pasojë e mosefikasitetit të DASh-it

**Prishtinë, 28 shkurt** - Kryeprokurori i Gjykatës Speciale për Krime Lufte, David Schwendiman, është larguar nga detyra, kryesisht për faktin se Departamenti Amerikan i Shtetit nuk e ka kryer siç duhet punën, ka shkruar e përditshmja britanike "The Guardian". Schwendiman ka thënë se nuk ka njohuri nëse kërkimi për pasardhësin e tij ka nisur ende. "Nuk më është dhënë asnjë garanci. Që prej dy javësh ka vetëm heshtje rreth kësaj çështjeje", i ka thënë ai së përditshmes "Guardian", gjatë një bisede telefonike me gazetën.
Schwendiman ka thënë se ishte pajtuar ta pranojë pozitën e kryeprokurorit me kusht që të garantohej pavarësia e tij financiare dhe politike dhe se ishte paraparë të shërbente në këtë funksion deri në vitin 2020. Përvoja e tij pasqyron raportimet e shpeshtuara për mungesë vendimesh dhe paralizë në Departamentin Amerikan të Shtetit përballë shkurtimeve të thella buxhetore, shkruan "The Guardian", duke shtuar se 40 pozita ambasadorësh në vende të ndryshme të botës vazhdojnë të mbeten ende të paplotësuara.
Megjithatë, Schwendiman është i bindur se largimi i tij në fund të muajit mars nuk do ta pengojë punën e gjykatës. "Njerëzit në rajon, ata të cilët duhet të brengosen se do të mbahen përgjegjës, nuk kanë pse të gëzohen. Vlerësimi im i sinqertë është se ky vendim nuk do të na ngadalësojë. Kur të vijë koha, do të bëjmë atë që duhet të bëjmë", citohet të ketë thënë Schwendiman për gazetën "The Guardian".
Pas largimit të Schwendimanit, Kwai Hong Ip, zëvendësi i tij, do të marrë përsipër detyrën si Prokuror i Specializuar i Përkohshëm që të sigurohet vazhdimësi në punën e filluar. Mandati i Gjykatës Speciale për Krime Lufte përkufizohet kryesisht në hetimet dhe gjykimet e rasteve të pretenduara të krimeve të luftës nga ana e disa ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndaj pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe kundërshtarëve, që përfshin periudhën kohore nga viti 1998 e deri në fund të vitit 2000.

# Agjencia e Kosovës për Akreditim përjashtohet nga EQAR-ja

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është përjashtuar nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR). Shkas për këtë vendim është bërë shkarkimi i jashtëligjshëm i anëtarëve të bordit dhe të menaxhmentit të Agjencisë së Akreditimit




EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

**Prishtinë, 28 shkurt** - Ndërhyrja e politikës në arsim ka bërë që Komiteti i Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) ta përjashtojë Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA). Kjo ka ndodhur për shkak të vendimit që është marrë për shkarkimin e anëtarëve të bordit dhe të menaxhmentit të AKA-s.

Në dokumentin e vendimit të EQAR-së është thënë se Komiteti i Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) ka konstatuar se, si pasojë e shkarkimit të bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga ministri Shyqyri Bytyqi, agjencia më nuk është e aftë të veprojë në mënyrë të pavarur dhe nuk është më në një pozitë që merr 'përgjegjësi të plotë për veprimet e veta', siç kërkohet nga standardi 3.3 i ESG-së. "Komiteti i Regjistrimit nuk ka mundur t'i identifikojë rrethanat që e arsyetojnë shkarkimin nga ministri, shkarkim i cili ka pasur efekte të dëmshme në pavarësinë dhe aftësinë e bordit për të funksionuar pa pasur rrezik serioz të ndikimit nga palët e treta", është thënë në dokumentin njoftues të EQAR-së.

Ish-kryetari i Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Blerim Rexha, i cili është shkarkuar nga ministri i MAShT-it nga kjo pozitë, e ka quajtur lajm të keq për institucionet e arsimit të lartë përjashtimin e AKA-s nga Komiteti i Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR). "Ky është një lajm i keq për të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe për të gjithë studentët e Kosovës. Se shkarkimi i të gjithë anëtarëve të Bordit të Agjencisë dhe ushtruesit të detyrës ishte bërë pa bazë ligjore, tani po e konfirmon edhe EQAR. Është për shumë keqardhje forma si ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, mundohet t'i arsyetojë veprimet tendencioze dhe skandaloze para EQAR-it", ka shkruar Rexha në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se pas vendimit për shkarkimit të bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), ky institucion është para shpërbërjes. "Agjencia e Akreditimit tani me staf të përgjysmuar është gati para shpërbërjes, ndërsa me këtë veprim po shkatërrohet i gjithë reputacioni, i ndërtuar me vite dhe me shumë mund, i të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Ndoshta ky ka qenë edhe synimi final i ministrit Bytyqi dhe klikës së tij!", ka thënë Rexha.

# IKShP-ja: Intensiteti i gripit sezonal në Kosovë po bie

Nga 1 tetori deri më 25 shkurt të këtij viti në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë raportuar gjithsej 49 343 raste të dyshimta me grip. Sipas këtij instituti, epidemia e gripit sezonal ka rënie të dukshme



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 28 shkurt** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) ka njoftuar se ka rënie të rasteve të gripit në Kosovë. "Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë mbikëqyrjes permanente të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, përmes sistemit të mbikëqyrjes së situatës epidemiologjike në raportin përmbledhës, ka konstatuar intensitet konstant të rasteve të gripit sezonal. Nga 1 tetori deri më 25 shkurt 2018 në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë raportuar gjithsej 49 343 raste të dyshimta me grip, 4 454 raste me infeksion respirator akut dhe 89 raste Sari (Sëmundje e Rënde Respiratore Akute). Gjatë javës së tetë të 2018-s janë raportuar 4 638 (25.2 për qind më pak) raste të dyshimta në grip, 277 raste me Infeksion Respirator Akut dhe 5 raste Sari (Sëmundje e Rënde Respiratore Akute)", është thënë në njoftimin e IKShP-së.

Sipas këtij njoftimi, në Institutin Kombëtar prej fillimit të sezonit të gripit, 251 persona kanë rezultuar pozitivë në influencë. "105 raste janë pozitive në influencën A dhe 146 në influencën B. 26 raste i takojnë subtipit A(H1) pdm 09 dhe 79 raste të tjera janë A të pa subtipizuara. 146 raste të konfirmuara i takojnë tipit B, 48 prej tyre janë subtipi 'Yamagata' ('gripi japonez'). Epidemia e gripit sezonal ka rënie të dukshme në intensitet", është theksuar në njoftimin e IKShP-së.

Instituti Kombëtar u rekomandon qytetarëve të kenë kujdes dhe të mos dalin gjatë në ambient të ftohtë, sidomos në javën vijuese. "Qytetarët të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura me dendësi të madhe të njerëzve dhe të përdorim sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina. Të gjithë personat që ndihen të sëmurë duhet të paraqiten sa më herët te mjeku familjar për t'i parandaluar komplikimet. Epidemiologët e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë së Kosovës vazhdojnë ta përcjellin me vëmendje ecurinë epidemiologjike në rajon, Evropë dhe botë", është thënë në njoftimin e IKShP-së.

## Sot lëshohen patentëshoferët me dizajn të ri

Prishtinë, 28 shkurt - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), sot (e enjte), në orën 13:00, do ta filojë lëshimin zyrtar të patentëshoferëve me dizajn të ri. "Gjatë kësaj ceremonie ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, do të pajisë disa qytetarë të Republikës së Kosovës me patentëshoferët e rinj", është thënë në njoftimin e MPB-së. Ceremonia do të mbahet në objektin e Agjencisë për Regjistrim Civil.



20 vjet nga masakra e Likoshanit dhe Çirezit

# Liderët: Historia e re e Kosovës i ka rrënjët në Likoshan e Çirez

**Në nderim të sakrificës së dëshmorëve dhe martirëve të Likoshanit e të Çirezit, të mërkurën është mbajtur akademi përkujtimore, në të cilën është vlerësuar lart kontributi i të rënëve për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Në 20-vjetorin e kësaj masakre, drejtuesit e shtetit kanë thënë se Drenica ndër shekuj ka qenë vatër e kryengritjes. Sipas tyre, historia e re e Kosovës i ka rrënjët në Likoshan dhe Çirez**




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Nën përkujdesjen e presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën është mbajtur akademi përkujtimor me rastin e shënimit të 20-vjetorit të masakrës së Likoshanit dhe Çirezit. Me këtë rast, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Kosova me nderimet më të larta shtetërore po e kujton 20-vjetorin e sakrificës së dëshmorëve dhe martirëve të Likoshanit dhe Çirezit, të rënë për liri dhe pavarësi. "Ky përvjetor po përkon me shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Qytetarët tanë e festuan me dinjitet vitin jubilar të shtetit të tyre. Kjo e arritur historike e Kosovës nuk do të bëhej pa sakrificën, gjakun dhe flijimin e më të dashurve tuaj këtu e njëzet vjet më parë", ka thënë ai.

Thaçi ka theksuar se më 28 shkurt 1998 Kosova hyri në një fazë të re politike dhe ushtarake. "Pas masakrës në Likoshan dhe Çirez, nuk vonoi sulmi edhe mbi Prekaz, ku ndodhi Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Kosova po hynte në rrugën e pashmangshme të imponuar të luftës për liri. Ushtria Çlirimtare e Kosovës rritej çdo ditë e më shumë. Dhuna e policisë dhe ushtrisë serbe nuk u ndal asnjë çast në vitet 1998-1999. Përkundrazi, u thellua edhe më shumë me masakrat e Abrisë, Reçakut, Izbicës, Rezallës, Krushës, Mejës, Qyshkut dhe shumë të tjerave", ka thënë Thaçi, duke shtuar se kjo sakrificë, bashkë me rezistencën e UÇK-së dhe të gjithë qytetarëve për liri dhe pavarësi, si dhe orientimi kah vlerat civilizuese perëndimore, bënë që Kosova ta fitojë përkrahjen e botës demokratike, të ShBA-së, BE-së dhe NATO-s. "Pavarësisht prej sfidave, Kosova e ka të qartë objektivin dhe opsionin e vetëm strategjik, integrimin euroatlantik në NATO, BE dhe OKB. Kosova nuk e harron asnjëherë të kaluarën e saj, sa të lavdishme dhe krenare, po aq edhe të dhimbshme", ka thënë Thaçi.

Për veprat e trimërisë, kontributin dhe sakrificën në luftën e UÇK-së, presidenti Thaçi në 20-vjetorin e rënies ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" dëshmorët Rexhep Ajet Rexhepi dhe Beqir Brahim Rexhepi.

Në këtë akademi ka marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci. Ai ka thënë se 20 vjet 'Te gjashtë lisat', në mes të Likoshanit dhe Çirezit, pati filluar lufta frontale me armikun shekullor, e cila kulmoi më pas me çlirimin e Kosovës. "20 vjet më parë filloi matja e forcave që do ta shënonte fillimin e fundit të okupimit serb. Trimave në këtë betejë u printe Rasim Kiçina, i përbetuari i betejave. Pas përleshjes frontale, kriminelëve do t'u vinte krah makineria e rëndë, por edhe helikopteri duke goditur nga ajri. Kurse ushtarëve tanë në ndihmë do t'u vinte legjendari Adem Jashari me bashkëluftëtarët që tashmë kishin krijuar zonat e rezistencës së armatosur. Jemi këtu për ta përkujtuar këtë pjesë të historisë sonë të re, betejën e Likoshanit dhe të Çirezit. Lavdi e përjetshme të gjithë të rënëve për liri!", ka thënë Lladrovci.



Ndërsa kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se 20-vjetori i betejës së lavdishme 'Te gjashtë lisat' e bën më madhështor 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Ai ka theksuar se nga 28 shkurti i vitit 1998 lufta ka marrë dimension tjetër, dimension që historia ia kishte ngarkuar edhe familjes Jashari dhe kombit shqiptar. "Së bashku me Komunën e Drenasit përkujtojmë me nderim të veçantë dëshmorët e betejës së Likoshanit dhe Çirezit. Ata treguan se asnjë forcë hakmarrëse më nuk mund ta shuante vatrën e çlirimit e të lirisë, Drenicën heroike. Drenica me shekuj ishte vatër e kryengritjes së filluar nga Ahmet Delia e diplomacia e Hasan Prishtinës për të vijuar me Azem Bejten. Për të vazhduar me Shaban Polluzhën e Mehmet Gradicën. Ky gjerdan i ndritur i rezistencës shqiptare do të kulmojë me rezistencën heroike të Tahir e Nebih Mehës", ka thënë Bekim Jashari, duke shtuar se kjo rezistencë nuk ishte e mjaftueshme. "Në vend se të ndaleshin presioni dhe dhuna jugosllave ndaj Drenicës dhe Kosovës, ato shtoheshin. Baba Shaban, si mësues dhe largpamës shembullor, e dinte se nga duhet të shkojë historia. Ai me familje zgjoi krenarinë e të qenit shqiptar, dinjitetit e burrërisë së lavdishme shqiptare", ka thënë Jashari, duke shtuar se më shumë se kurrë Kosova ka nevojë për bashkim dhe unitet. "Në këtë përvjetor, duke kujtuar të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët në Drenicë dhe në gjithë Kosovën, bëhet betejë me mjete të tjera, për zhvillim, për arsim, për mirëqenie dhe për shëndetësi më cilësore. Ne kemi nevojë të jemi më të bashkuar se kurrë. Kemi nevojë më shumë se kurrë për unitet", ka deklaruar Jashari.

20-vjetorin e masakrës së Likoshanit dhe Çirezit e ka përkujtuar edhe kryeministri Ramush Haradinaj, duke thënë se 20 vjet më parë ka filluar një kapitull i ri i luftës për çlirim. "Më 28 shkurt, njëzet vjet më parë, filloi një kapitull i ri i luftës sonë për çlirim. Historia e re e Kosovës i ka rrënjët në Likoshan e Çirez. Dëshmorët e martirët e kësaj masakre janë pjesë e kujtesës shtetërore. Flijimi i tyre është frymëzim për brezat që vijnë, për ta ruajtur lirinë me çdo çmim. Lavdi e përjetshme", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Në Deçan do të ngrihet shtatorja e dëshmorit Beg Rizaj



**DEÇAN, 28 SHKURT** - Kuvendi Komunal në Deçan, pas kërkesës së OVL - UÇK-së Dega në Deçan, me nr. të protokollit 5262, të datës 21. 2. 2018, ka aprovuar unanimisht ndarjen e lokacionit për ngritjen e shtatores së dëshmorit të kombit, Beg Rizaj. Qytetarë, bashkëluftëtarë dhe familjarë të Begut janë duke kontribuar për grumbullimin e mjeteve të nevojshme për ndërtimin e këtij monumenti në përkujtim dhe nderim të rënies heroike të tij.

# Miratohet strategjia sektoriale dhe plani i veprimit i MPMS-së

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Kabineti qeveritar, në mbledhjen e së mërkurës, ka miratuar Strategjinë Sektoriale dhe Planin e Veprimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) 2018-2022.

Ministri i MPMS-së, Skender Reçica, ka thënë se Strategjia Sektoriale ka për qëllim përmirësimin e politikave të shërbimeve publike në fushën e punësimit dhe mirëqenies së qytetarëve dhe synon të udhëzojë dhe koordinojë veprimet për arritjen e objektivave zhvillimore të parapara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, e që kanë të bëjnë me uljen e nivelit të papunësisë, me fokus tek të rinjtë dhe gratë, për ngritjen e aftësive profesionale të fuqisë punëtore, si dhe fusha të tjera të rëndësishme.

Ai ka theksuar se për ta realizuar vizionin e kësaj strategjie janë paraparë katër objektiva: ulja e inaktivitetit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve në përputhje me nevojat e tregut të punës; përmirësimi i kushteve të punës dhe zvogëlimi i informalitetit, përmes fuqizimit të mbikëqyrjes dhe forcimit të dialogut social; rritja e mirëqenies sociale, përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë së mbrojtjes dhe shërbimeve sociale e familjare; si dhe realizimi i të drejtave në përfitime për pensionistët, përmes zhvillimit të sistemit të qëndrueshëm pensional, harmonizimit të kornizës ligjore dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale njerëzore e teknologjike. Kjo strategji është pjesë përbërëse e dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës dhe bazohet edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, gjithashtu edhe në masat e parapara në Agjendën për Reforma Evropiane, Programin e Reformave Ekonomike, Strategjinë e Evropës Juglindore 2020 dhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.





# Beqaj: Reforma në arsim, burim i inovacionit dhe ideve inovative që duhet t'i mbështesë shteti

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, në kuadër të aktiviteteve dhe me qëllim të promovimit të ideve inovative dhe edukimit në shërbim të inovacionit, ka vizituar shkollën private inovative "Hello" në Gjilan.

Gjatë kësaj vizite ministri Beqaj ka vizituar ambiente e shkollës dhe laboratorët e saj, ku ka takuar nxënës dhe mësimdhënës, si dhe ka bashkëbiseduar me drejtoreshën Hysnije Ismaili.

Ministri Beqaj ka uruar për punën stafin e shkollës, në veçanti drejtoreshën Ismaili, duke theksuar rëndësinë që ka edukimi i mirëfilltë i fëmijëve edhe në shërbim të inovacionit. "Sistemi i reformimit të shkollave është burim i inovacionit dhe ideve inovative të cilat ne pretendojmë që në të ardhmen duhet t'i trajtojë shteti dhe shoqëria në përgjithësi", ka thënë ministri, Besim Beqaj.

Drejtoresha Hysnije Ismaili e ka njoftuar ministrin Beqaj me formatin e shkollës, aktivitetin e saj në procesin edukativ të fëmijëve, si dhe me proceset inovative që realizohen këtu. Ajo ka thënë së shkolla "Hello" është shkollë e veçantë dhe inovative pasi aplikon edukimin e planprogrameve nga MAShT-i, por me ditar të digjitalizuar dhe me sistem të avancuar digjital të mësimdhënies.

# Çmimet e inputeve bujqësore shënojnë rënie për 2.8 për qind

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 28 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi për periudhën 2015-2017. Për të bërë krahasime dhe për t'i vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për vitet 2015-2017 dhe për vitin bazë 2015. Sipas një njoftimi për medie të ASK-së, është thënë se ky publikim është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë.

Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinare, në kompani, tregje dhe në vende të tjera, ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Bëhet me dije se disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit (IHÇK) në ASK. "Produktet, të cilat e përbëjnë bazën për Indeksin e Çmimit të Inputeve, janë të ndara në dy grupe kryesore: mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinari, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtje e materialeve, mirëmbajtje e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime të tjera. Sa iu përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje të tjera), ndërtesat dhe të tjera (ndërtesat jorezidente të fermës, punët e tjera, përveç përmirësimit të tokës)", është theksuar në njoftimin e ASK-së.

Më tej, në këtë njoftim thuhet se në vitin 2017 Indeksi vjetor i inputeve ka rënie për (-2.8 %) për Input 1, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Indeksi për Input 2 ka rritje për 1 % ndërmjet viteve 2017 dhe 2016. Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rënie për (-1.1 %), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. "Në vitin 2017, Indeksi vjetor i Inputeve ka rënie për (-4.6 %) për Input 1, krahasuar me vitin 2015. Indeksi për Input 2 ka rritje për 3.2 % ndërmjet viteve 2015 dhe 2017. Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rënie për (-1.1 %), krahasuar me vitin 2015", është bërë me dije në njoftimin e ASK-së.



# Forumi i parë ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës mbahet në qershor

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHKURT - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës dhe Ambasadën e Danimarkës në Zagreb, kanë filluar përgatitjet për organizimin e forumit të parë ekonomik në mes të Kosovës dhe Danimarkës që do të mbahet më 8 qershor të këtij viti. Përvoja e Danimarkës në qëndrueshmëri ekonomike dhe zhvillim të përgjithshëm është e mirëseardhur për rrugëtimin e Kosovës bazuar në këto përvoja drejt ardhmërisë.

OEK-u ka njoftuar se takime të tilla janë një mundësi e mirë për ta forcuar bashkëpunimin ekonomik i cili bazohet edhe në raporte shumë të mira politike në mes të dy shteteve mike. "Sektorët në të cilët do të funksionojnë në këtë forum janë të rëndësisë së pakontestuar që kanë të bëjnë me avancim të partneritetit publiko-privat, ambientalizëm, urbanizëm, planifikim dhe në efiçiencë të energjisë. Interesant është mobilizimi i bazuar në përvojën e Danimarkës sa i përket planifikimit urban, ku komunat e Kosovës kanë nevojë për një transferim të përvojave të tilla", është thënë në njoftimin e OEK-ut. Po ashtu, është bërë me dije se në këtë forum do të prezantohen edhe raste konkrete të përvojave me standarde ndërkombëtare. "Do të organizohen takime B2B (biznes me biznes) me qëllim që sektori privat dhe ai publik t'i shfrytëzojnë përvojat e zhvillimit nga një ndër shtetet më të zhvilluara në Evropë siç është Danimarka", është theksuar në njoftimin e OEK-ut.






# Oda Ekonomike zyrtarizon bashkëpunimin ekonomik me Britaninë e Madhe

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Tregtare e Londrës Jugore kanë nënshkruar memorandum të bashkëpunimit për ta avancuar dhe zgjeruar bashkëpunimin me partnerë të rëndësishëm në Britaninë e Madhe, me fokus të veçantë me Londrën si metropol evropian.

Sekretari gjeneral i OEK-ut, Parim Bajrami dhe drejtori i Odës Tregtare të Londrës Jugore, Gerry Macdoaugh, me bashkëpunëtorë, nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit që do të jetë një platformë e re për ta avancuar bashkëpunimin ekonomik në mes të dy shteteve mike. "Përmes këtij memorandumi do të angazhohemi që së bashku ta mundësojmë lidhjen dhe përafrimin e bizneseve të vendeve tona, duke ua ofruar atyre informatat e nevojshme për bashkëpunim mes vete", ka deklaruar ai.

Bajrami ka shtuar se përmes këtij memorandumi të dy odat do të angazhohen për organizimin e përbashkët të misioneve tregtare, forumeve të përbashkëta Ekonomike B2B dhe pjesëmarrjes në panaire të përbashkëta. Ai ka pohuar se ky memorandum është edhe një hap shtesë i kontributit të dhënë nga Oda Ekonomike e Kosovës për ndërkombëtarizimin e ekonomisë vendore dhe forcimin e partneritetit strategjik me shtetet e fuqishme që hapin një perspektivë të re siç është Britania e Madhe. Kosova në Samitin e Londrës ka prezantuar afër 40 projekte me një vlerë implementuese rreth 600 milionë euro.

# Dy inspektorë tatimorë dyshohen për korrupsion



**Prishtinë, 28 shkurt** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se, bazuar në informatat e pranuara nga Prokuroria dhe duke u mbështetur në nenin 69 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ka marrë vendim mbi pezullimin parandalues nga marrëdhënia e punës në këtë institucion për dy inspektorë tatimorë të dyshuar për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. "Menaxhmenti i ATK-së siguron opinionin se çdo informatë e dëshmuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe rasteve korruptive do të dërgohet në organet kompetente për trajtim dhe ndaj të gjithëve që shpallen fajtorë për vepra penale do të ndërmerren masat e largimit nga marrëdhënia e punës në institucionin tonë", është thënë në njoftimin e ATK-së.

# Parku i biznesit do të ndërtohet në fshatin Lumadh

**Vushtrri, 28 shkurt** - Përfaqësues të bizneseve të Vushtrrisë, por edhe përfaqësues të fshatrave Lumadh, Stanovc i Epërm dhe Stanofc i poshtëm, janë pajtuar për ndërtimin e Parkut të biznesit në fshatin Lumadh të kësaj komune.



Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka folur për investimet që do të bëhen aty. "Në Parkun e Biznesit në Lumadh, që përfshinë një hapësirë prej 14 hektarëve, synojmë të punësohen 1 000 persona", ka thënë Tahiri. Ai ka bërë me dije se tashmë nga buxheti i shtetit janë siguruar 1 milion e 200 mijë euro për investime në periudhën trevjeçare në Parkun e Biznesit. "Punësimin e njerëzve e bëjnë bizneset, e komuna është këtu që t'u krijojë kushte sa më të mira bizneseve për rritjen e kapaciteteve të tyre prodhuese e shërbyese", ka thënë kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri.

# Premtohet dyfishim i buxhetit për fermerët e Suharekës



**Suharekë, 28 shkurt** - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka pritur të mërkurën zëvendësministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Vesel Krasniqi, i cili ishte i shoqëruar edhe nga zëvendësministri i Administratës së Pushtetit Lokal, Sami Hajdaraj. Kryetari Muharremaj i ka njoftuar të dy zëvendësministrat me planet që ka për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Komunën e Suharekës, me ç'rast ka theksuar se do ta ndihmojë sektorin e bujqësisë në të gjitha mënyrat. "Do ta formoj Odën e Bujqve e cila pastaj do të jetë në kontakt me fermerë të të gjitha fshatrave. Do ta përkrahim sektorin e blegtorisë në viset malore, do ta ndërtojmë tregun ditor në qytet për t'u siguruar hapësirë prodhuesve bujqësorë për produktet e tyre", ka thënë ai.

Ndërsa zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Vesel Krasniqi, ka premtuar se Ministria e Bujqësisë vitin e ardhshëm do ta shtojë buxhetin për fermerë dyfishë më shumë sesa e ka tani.

# Fermerët në Rahovec aplikojnë për pagesa direkte në bujqësi

**Rahovec, 28 shkurt** - Në Komunën e Rahovecit, përkatësisht në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZhR), ka filluar aplikimi nga ana e fermerëve për pagesa direkte të cilat jepen nga granti qeveritar.

Drejtori i Drejtorisë së BPZhR-së, Berat Duraku, ka thënë se si drejtori në koordinim edhe me kryetarin e komunës, Smajl Latifi, kanë njoftuar me kohë fermerët për hapjen e periudhës së aplikimit për pagesa direkte. "Për ta shkurtuar pritjen për aplikim kemi angazhuar punëtorë shtesë me qëllim që fermerët të mos presin gjatë, në mënyrë që fermerët të aplikojnë në afatin e paraparë kohor", ka



thënë Duraku. Ai ka bërë thirrje për të gjithë fermerët e komunës që konform afatit të paraparë deri më 31 mars të aplikojnë për të përfituar nga pagesat direkte-subvencionet, që bëhen në bashkëpunim në mes të komunës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

## NGJARJE NGA RAPORTI I POLICISË

### Shtiu me armë drejt një personi në veturë

**Pejë, 28 shkurt** - Në rrugën "Eliot Engel" në Pejë një person ka deklaruar se derisa ka qenë në lëvizje me veturën e vet, nga një veturë tjetër, një i dyshuar i panjohur, ka shtënë me armë zjarri në drejtim të tij. Sipas viktimës, paraprakisht me të dyshuarin kishte një mosmarrëveshje në komunikacion. Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe konfiskuar dy gëzhoja të kalibrit 7.65 mm. Përveç dëmeve materiale, në veturën e viktimës nuk raportohet për të lënduar.

### Arrestohen dy të dyshuar për shantazh, kërkuan të holla dhe stoli

**Prizren, 28 shkurt** - Policia e Kosovës ka njoftuar se në lagjen "Kurilla" të Prizrenit policia ka identifikuar dhe arrestuar dy të dyshuar, njëri shqiptar e tjetri turk, për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se në mënyra të ndryshme kishin shantazhuar dhe kanosur dy viktima femra. Ata u kishin kërkuar atyre të holla dhe stoli ari. Me urdhër të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

### Një person arrestohet pasi rrahu familjarët

**Ferizaj, 28 shkurt** - Në qytetin e Ferizajt është arrestuar një i dyshuar pasi kishte sulmuar fizikisht anëtarët e familjes. Policia e Kosovës ka njoftuar se si pasojë e sulmit viktimat kanë pësuar lëndime të lehta trupore. Me urdhër të prokurorit i dyshuari është dërguar në mbajtje.

### Arrestohen tre persona për vjedhje në Prishtinë

**Prishtinë, 28 shkurt** - Policia e Kosovës ka njoftuar se në rrugën "Tringë Smajli" në Prishtinë, pas hetimeve të zhvilluara, janë identifikuar dhe arrestuar tre të dyshuar. Nga të dyshuarit është konfiskuar një TV i cili dyshohet të jetë i vjedhur. Me urdhër të prokurorit një nga të dyshuarit është dërguar në mbajtje, kurse dy të dyshuarit e tjerë janë liruar në procedurë të rregullt.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (16)

# MIRËNJOHJE DHE ÇMIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN



Selatin NOVOSELLA

1. Revista "Forumi" (21 shkurt 1994): Adem Demaçi propozohet për çmimin "Nobel" për paqe
Revista "Forumi", e cila botohet në Prishtinë, e datës 21 shkurt 1994, njofton se Adem Demaçi është në mesin e të propozuarve të tjerë për çmimin "Nobel" për paqe, për vitin 1994.
2. Gazeta "Bujku" (26 tetor 1995): Adem Demaçit iu dha çmimi "Lizel dhe Lio Aitinberg"
TVSH-ja dhe gazeta "Bujku" njoftojnë se Universiteti i Osllos, për vitin 1995, i ndau Adem Demaçit Çmimin tradicional të këtij universitet "Lizel dhe Aitinberg", i cili mbanë emrat e bashkëshortëve, të cilët gjithë jetën ia kushtuan luftës për lirinë dhe të drejtat e njeriu.
3. Komuna e Prishtinës (28 nëntor 1999): Adem Demaçit i ndahet mirënjohja "Çlirimtar i Prishtinës"
Me rastin e shënimit të 28 Nëntorit 1999, në Prishtinën e lirë pas 28 nëntorit 1912, Komuna e Prishtinës i ndau Adem Demaçit mirënjohjen "Çlirimtar i Prishtinës".
4. Akademia Kulturore "Iliria" (19 prill 2002): Adem Demaçit i ndahet "Medalja e Akademisë" nga Akademia Kulturore "Iliria"
Akademi Kulturore "Iliria", në Romë, më 19 prill 2002, ia ndanë "Medaljen e Akademisë" personalitetit të shquar shqiptar, Adem Demaçit. Kjo Medalje është e nënshkruar nga Nermin Vlora-Falaski.
5. Shoqata "Mëmëdheu" (23 shkurt 2003): Adem Demaçit i ndahet mirënjohje nga Shoqata "Mëmëdheu"
Me rastin e 10-vjetorit të Shoqatës Kulturore Shqiptare "Mëmëdheu", në St. Gallen të Zvicrës, i ndahet Adem Demaçit mirënjohje me motivacion: "Për kontributin e dhënë në mbarëvajtje të veprimtarisë së Shoqatës dhe kontributin e veçantë në luftën çlirimtare të UÇK-së".
6. SHBPK (27 nëntor 2006): Adem Demaçit i jepet mirënjohje nga SHBPK
Me rastin e 10-vjetorit të themelimit të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, i ndahet mirënjohje Adem Demaçit, "Për kontribut të jashtëzakonshëm në çështjen e Lirisë si dhe në frymëzimin, organizimin dhe kalitjen e brezave të shumtë të luftëtarëve të lirisë". Mirënjohjen ia dorëzon kryetari i SHBPK-së, Hydajet Hyseni.
7. Klubi Krijues "Rrjedha" (17 janar 2007): Adem Demaçit i ndahet Çmimi "Jusuf Gërvalla"
Siç njofton gazeta "Focus" e Prishtinës, në manifestimin e Klubit Krijues "Rrjedha" në Deçani, i cili u mbajt nën patronatin e Kryeministrit të Kosovës, Agim Çeku, iu nda Adem Demaçit Çmimi "Jusuf Gërvalla", për vitin 2007.
8. LSHK (28 tetor 2007): Adem Demaçi fitoi shpërblimin "Pjetër Bogdani"
Siç njofton gazeta "Koha Ditore" e Prishtinës, në manifestimin "Takimet e shkrimtarëve Hivzi Sulejmani", ish-kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, Adem Demaçi, fitoi çmimin kryesor "Hivzi Sulejmani" për vitin 2007, për romanin "Dashuria kuantike e Filanit".
9. Qeveria e Kosovës (27 nëntor 2008): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Kryeministri i Kosovës
Me rastin e shënimit të 40-vjetorit të demonstratave të vitit 1968, Adem Demaçit, i ndanë mirënjohje Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me këtë motivacion: "Për misionin frymëzues te organizatorët e demonstratave të para të pas Luftës së Dytë Botërore, me kërkesa për: "Vetëvendosje për Viset Shqiptare në pushtimin e ish-Jugosllavisë, Republikën e Kosovës, Flamurin kombëtar, Universitetin e Prishtinës".
10. Komuna e Tetovës (21 dhjetor 2008): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Komuna e Tetovës
Me rastin e shënimit të 40-vjetorit të demonstratave të vitit 1968 në viset shqiptare në Maqedoni, Adem Demaçit i ndanë mirënjohje kryetari i Komunës së Tetovës, Hazbi Lika, me motivacion: "Simbolit të qëndresës shqiptare dhe frymëzuesit për organizimin e Demonstratave të vitit 1968, me kërkesat për: "Vetëvendosje të trojeve shqiptare në ish-Jugosllavi, përdorimin e flamurit kombëtar dhe hapjen e Universitetit në gjuhën shqipe".
11. Komuna e Gjilanit (janar 2009): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Komuna e Gjilanit
Me rastin e organizimit të manifestimit tradicional "Flaka e Janarit 2009", Adem Demaçit i ndahet mirënjohje nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa.
12. Komuna e Kërçovës (17 janar 2009): Adem Demaçit i ndahet mirënjohje nga Komuna e Kërçovës
Me rastin e organizimit të Manifestimit "Flaka e Janarit 2009" në Kërçovë, Adem Demaçit iu nda mirënjohje me motivacion: "Për kontributin atdhetar të dhënë gjatë kthesave historike kombëtare", të nënshkruar nga Fazli Veliu, kryetar i Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.
13. Komuna e Vushtrrisë (8 tetor 2009): Adem Demaçit i ndahet Çmimi "Hasan Prishtina"
Në manifestimin kulturor "Ditët e Hasan Prishtinës", i mbajtur në Vushtrri, më 8 tetor 2009, iu nda Adem Demaçit Çmimi "Hasan Prishtina". Vendimin për ndarjen e këtij Çmimi të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë e lexoi kryesuesi i komunës, Ferit Idrizi.
14. Komuna e Drenasit (15 qershor 2010): Adem Demaçi shpallt "Qytetar Nderi" i Drenasit
Siç njofton gazeta "Epoka e ee" e Prishtinës, këshilltarët e Komunës së Drenasit, me votat e tyre unanime, kanë vendosur që: "Për kontributin e tij të madh për çështjen kombëtare dhe për rezistencën dhe qëndresën e vazhdueshme në gjitha fazat e përpjekjeve për lirinë e Kosovës, Adem Demaçin ta shpallin "Qytetar Nderi" të Drenasit.
15. SHFD dhe SHIL (nëntor 2010): Adem Demaçit i japin mirënjohje SHFD të UÇK-së dhe SHIL të UÇK-së
Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dhe Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, i japin mirënjohje Adem Demaçit me këtë motivacion: "Simbolin e rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, për kontributin e jashtëzakonshëm të dhënë për çlirimin e Kosovës".
16. Presidenca e Kosovës (26 nëntor 2010): Adem Demaçit i jepet urdhri "Hero i Kosovës"
Në vigjilje të Festës së Flamurit, U.D. së presidentit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, i jepet Adem Demaçit dekorata më e lartë e Republikës së Kosovës Urdhri "Heroi i Kosovës", me këtë motivacion: "Për kontribut të veçantë dhënë frymëzimit politik dhe udhëheqjes së rezistencës e luftës për liri e bashkim kombëtar të trojeve shqiptare".
17. Komuna e Malishevës (3 dhjetor 2010): Adem Demaçit i ndahet Çmimi "Dr. Tafil Kelmendi"
Shoqata për Kulturë dhe Letërsi e Malishevës. "Dr. Tafil Kelmendi", i ndau Çmimin vjetor Adem Demaçit, me motivacion: "Ky Çmim i ndahet Adem Demaçit për kontributin e dhënë në fushën e kulturës, veçmas në krijimtarinë letrare".
18. Presidenca e Shqipërisë (10 qershor 2012): Adem Demaçit i jepet dekorata "Nderi i Kombit"
Me rastin e shënimit të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, presidenti Bamir Topi i dha Adem Demaçit dekoratën më të lartë të Shqipërisë, "Nderi i Kombit". Në këtë solemnitet presidenti Topi tha: "Më lejoni të veçoj në nderimin e sotëm një emër simbol qëndrese dhe disidence, një intelektual atdhetar dhe qytetar, shkrimtarin dhe veprimtarin e të drejtave të njeriut, "Mendelën e Lirisë" dhe heroin e gjallë të Kosovës, Adem Demaçin. Miku im Adem, jemi me fat që ju kemi sot midis nesh. Ju keni qenë dhe jeni nderi i kombit shqiptar, por nga sot edhe zyrtarisht e meritoni këtë titull të lartë nderimi".
19. Krijuesit durrsakë (mars 2013): Krijuesit e Durrësit i ndajnë Adem Demaçit mirënjohje
Shoqata e Krijuesve durrsakë i ndajnë mirënjohje Adem Demaçit në Durrës. Mirënjohjen Demaçit ia dorëzon shkrimtari Nikolla Spatharim
20. Komuna e Rahovecit (12 mars 2013): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Komuna e Rahovecit
Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i jep mirënjohje Adem Demaçit, me këtë motivacion: "Me rastin e 32-vjetorit të demonstratave të vitit 1981, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare".
21. Kolegji "ILIRIA" (17 maj 2013): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Kolegji "ILIRIA"
Kolegji "ILIRIA" në Prishtinë i ndanë mirënjohje Komuna e Ferizajt, me rastin e përurimit të Trilogjisë së autorit Selatin Novosella kushtuar tri gjykimeve të Adem Demaçit. Mirënjohjen Demaçit ia dorëzon rektori i kolegjit, Mixhait Reçi.
22. Komuna e Ferizajt (19 tetor 2013): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Komuna e Ferizajt
Komuna e Ferizajt i ndanë mirënjohje Adem Demaçit, me rastin e përurimit të Trilogjisë së autorit Selatin Novosella, kushtuar tri gjykimeve të Demaçit. Mirënjohjen Demaçit ia dorëzon kryetari i komunës, Agim Aliu.
23. LKSH (28 nëntor 2014): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Lëvizja Kombëtare Shqiptare Pajtimi i Gjaqeve
Lëvizja Kombëtare Shqiptare Pajtimi i Gjaqeve, i ndanë Adem Demaçit mirënjohje me këtë motivacion: "Me rastin e 25-vjetorit të themelimit të kësaj Lëvizjeje, i ndanë mirënjohje Adem Demaçit për veprimtarinë atdhetare dhe humanitare".
24. Komuna e Prishtinës (11 qershor 2015): Zbulohet Pllaka kushtuar veprimtarisë së Adem Demaçit
Me rastin e Ditës së Çlirimit të Prishtinës, në lagjen "Tophane" është përuruar Pllaka kushtuar veprimtarisë së Adem Demaçit gjatë kohës sa ishte Përfaqësues Politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pllakën e zbuloi kryetari i komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti.
25. RTK (17 tetor 2015): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Radio Televizioni i Kosovës
Me rastin e shfaqjes së filmit dokumentar kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit, Radio Televizioni i Kosovës i ndanë Demaçit mirënjohje me motivacion: "Për kontributin e jashtëzakonshëm në avancimin e fjalës së lirë dhe zhvillimin e transmetuesit publik të Kosovës, RTK-së", të cilën ia dorëzon kryetari i bordit të RTK-së, Ismet Bexheti.
26. Komuna e Mitrovicës (2016): Me emrin e Adem Demaçit emërtohet një park në Mitrovicë
Në vitin 2016, me rastin e shënimit të 80-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit, komuna e Mitrovicës ka emërtuar një park të qytetit me emrin e Adem Demaçit.
27. Komuna e Prishtinës (2016): Me emrin e Adem Demaçit emërtohet një shesh në Prishtinë
Në vitin 2016, me rastin e shënimit të 80-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit, komuna e Prishtinës ka emërtuar një shesh të qytetit me emrin e Demaçit.
28. Komuna e Skenderajt (2016): Me emrin e Adem Demaçit emërtohet një rrugë në Skenderaj
Në vitin 2016, me rastin e shënimit të 80-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit, komuna e Skenderajt ka emërtuar një rrugë të qytetit me emrin e Adem Demaçit.
29. Komuna e Strugës (22 korrik 2016): Adem Demaçit i ndahet mirënjohje nga Komuna e Strugës
Me rastin e manifestimit kulturor të mbajtur në Strugë, më 22 korrik 2016, në shenjë nderimi për 80-vjetorin e lindjes së Adem Demaçit, kryetari i Komunës së Strugës, Zijadin Sela, i ndau "Mirënjohje" Adem Demaçit.
30. SHBPK (20 dhjetor 2016): Adem Demaçit i ndanë mirënjohje Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës
Në 20-vjetorin e themelimit të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës i ndahet mirënjohje me motivacin: "Për kontributin e tij të veçantë për themelimin e Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, për organizimin dhe afirmimin e saj, veprimtarinë e saj të suksesshme gjatë këtyre viteve dhe për rolin e tij udhëheqës dhe frymëzues për anëtarësinë e gjerë". Mirënjohjen Demaçit ia dorëzon kryetari i SHBPK-së, Hydajet Hyseni.
31. Asociacioni Ndërkombëtar i Edukatorëve për Paqe Botërore: "Diplomë nderi" për Adem Demaçin
Adem Demaçit, në vitin 1992, Asociacioni Ndërkombëtar i Edukatorëve për Paqe Botërore i ndau "Diplomë nderi" për njohje të shërbimit të jashtëzakonshëm ndaj komunitetit dhe interesimit të dukshëm për të gjithë njerëzit. **(Fund)**



# PRESIDENTI I PËRBASHKËT



Rexhep QOSJA

Në fjalimin e tij në mbledhjen solemne të Kuvendit të Kosovës kushtuar 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, më 18 shkurt të këtij viti, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përpos të tjerash, tha se në shënimin e 20-vjetorit të pavarësisë së saj, Kosova mund të ketë një kryetar që do të jetë kryetar i përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës dhe një politikë kombëtare të sigurisë.

Dhe, ky do të jetë kryetar i unitetit kombëtar shqiptar.

Kjo deklaratë e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, u prit me gëzim prej numrit më të madh të shqiptarëve kudo që jetojnë ata sot, por u prit mosdurueshëm, refuzueshëm prej një numri të njerëzve politikë shqiptarë në Kosovë dhe në Shqipëri.

Deklarata e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për kryetarin e përbashkët Shqipëri - Kosovë, u prit mospajtueshëm, por matur mospajtueshëm, prej Bashkimit Evropian dhe dëshpërueshëm prej Ambasadës së ShBA-së në Shqipëri.

Deklarata e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për kryetarin e përbashkët Shqipëri - Kosovë u prit me bajoneta prej Serbisë dhe kritikisht prej Greqisë.

Qëndrimet e tilla, mospajtuese të BE-së dhe të Ambasadës Amerikane me deklaratën në fjalë të kryeministrit Edi Rama, janë të kuptueshme. ShBA-ja dhe BE-ja janë faktorë të mëdhenj politikë, diplomatikë dhe ekonomikë, që bëjnë politikë botërore me të cilën vetvetiu ndiejnë obligim ta kënaqin, si thuhet, "krejt botën dhe babanë".

Është i kuptueshëm edhe qëndrimi i Greqisë ndaj kësaj deklarate të kryeministrit shqiptar, Edi Rama. Greqia, mike historike e Serbisë, nuk do të vetëquhej e lumtur po u bënë shqiptarët faktorë me rëndësi të veçantë politike dhe gjeostrategjike, çfarë do t'i bënte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë që ajo, si dikur, pa të drejtë, e quan Shqipëri e Madhe!

I kuptueshëm është edhe qëndrimi i vrazhdë, i egër, i Serbisë ndaj idesë për kryetarin e përbashkët Shqipëri - Kosovë. Pse jo? Serbia vazhdon të jetojë me mitin mesjetar në kokë për Kosovën si krahinë të saj!

I pakuptueshëm është, ndërkaq, qëndrimi i të parëve të Partisë Demokratike e të Lëvizjes Socialiste për Integrim në Shqipëri dhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës në Kosovë.

Nuk ka dyshim se ky qëndrim i tyre, i tri partive tona të përmendura, bie ndesh me interesat historike të popullit shqiptar.

Dhe, nuk ka dyshim se ky qëndrim i tyre është shprehje e një botëkuptimi krahinorist prej të cilit ende nuk janë liruar disa subjekte politike dhe një numër i njerëzve politikë as në Shqipërinë shtetërore, as në Kosovë.

Ata që i kanë përcjellë dhe i përcjellin paraqitjet politike të Edi Ramës qoftë si kryeministër, qoftë si kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, ata e dinë se deklarata e tij për kryetarin e përbashkët Shqipëri - Kosovë nuk përfaqëson ide të re në veprimtarinë e tij politike. Jo. Ajo në të vërtetë është vazhdim, është përthellim, është qartësim përmbajtjesor i politikës së tij kombëtare me përbërës mbarëkombëtarë. Propozimeve të tij për zhvillimin e disa veprimtarive të përbashkëta Shqipëri - Kosovë në një varg fushash politike, diplomatike, ekonomike, arsimore, shëndetësore, shkencore, kulturore e të tjera tani u është shtuar edhe propozimi për kryetarin e përbashkët të Shqipërisë - Kosovës pas njëzet vjetësh.

Propozimit të tij për krijimin e Akademisë së Shkencave, në të vërtetë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Shqipërisë dhe Kosovës, e cila, natyrisht, do të kishte një kryetar të përbashkët, tani i është shtuar propozimi për kryetarin e përbashkët Shqipëri - Kosovë.

Nuk është e nevojshme të theksohet veçmas se disa prej këtyre propozimeve e, sidomos, propozimi për krijimin e një Akademie Mbarëkombëtare të Shkencave dhe të Arteve, me kryetar të përbashkët, nuk është propozim i shqiptuar vetëm prej kryeministrit Edi Rama, por edhe prej disa intelektualëve të tjerë.

Por të gjitha këto propozime njësuese kombëtare kryeministri Edi Rama i ka përtashësuar duke e shtuar interesimin e opinionit jo vetëm kombëtar, por edhe mbarëkombëtar, në radhë të parë evropian dhe ballkanik, për to.

Le ta themi, më në fund, atë që e kam thënë edhe një herë: kryeministri i sotëm i Shqipërisë, Edi Rama, është politikani i parë shqiptar, i cili në takimet, në bisedat e në bisedimet me politikanë, diplomatë e shtetarë, para së gjithash ballkanikë dhe evropianë, ka sjellë qëndrime shqiptare, në të vërtetë mbarëshqiptare më të drejtpërdrejta, më të hapëta, më të dinjitetshme se asnjëherë më parë në historinë e politikës shqiptare, duke i liruar ato prej ngurrimeve, tkurrjeve, paragjykimeve, servilizimeve prej të cilave gjuha jonë politike e diplomatike nuk ishte gjithnjë e liruar dhe as nuk po mund të lirohet.

Ç'është e vërteta, me deklaratën në fjalë prej kundërshtarëve dhe mediokriteteve të nxjerrë prej kontekstit kuptimor të fjalimit të tij, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nuk e ka kërkuar ndryshimin e gjendjes shtetërore të përtashme të Shqipërisë dhe të Kosovës, por deshi-s'deshi vetë ai dhe deshën-s'deshën kundërshtarët e tij, e ka parathënë një ardhmëri të këtyre dy shteteve që në perspektivën historike është e pashmangshme.

Mendja historike, prandaj, këtë ardhmëri nuk e mohon në asnjë mënyrë dhe nën kurrfarë trysnish.

Nuk ka dyshim se kundërshtia e të parëve të partive të sipërtheksuara shqiptare ndaj deklaratës së kryeministrit Edi Rama është e pakuptueshme dhe e palejueshme jo vetëm pse me të interesin historik mbarëshqiptar ata ua flijojnë interesave të tyre të ngushta të përtashme partiake, por edhe pse është kundërdemokratike, anakronike dhe dogmatike. Ata janë shprehur ashtu kundërshtueshëm thuajse jetojmë ende në vitet tetëdhjetë a nëntëdhjetë të shekullit të kaluar! Ata janë shprehur ashtu kundërshtueshëm thuajse s'e shohin dhe s'e kuptojnë njëmendësinë e sotme organizuese evropiane! Bashkimin Evropian sot e përbëjnë 26 shtete. Të gjitha shtetet që e përbëjnë BE-në janë shtete të pavarura, me kryetar të tyre, me ushtri të tyre, me polici të tyre, me ministri të jashtme të tyre e me të gjitha institucionet e tjera që përbëjnë shtetin e pavarur. Por, Bashkimi Evropian ka sot edhe kryetarin e përbashkët, që quhet Zhan-Klod Junker, ka edhe ministren e Jashtme të përbashkët, që quhet Federika Mogerini, kurse tani e sa kohë po bisedohet që të ketë edhe një forcë të përbashkët ushtarake, që nuk do t'i mohojë ushtritë e shteteve të veçanta.

Në qoftë se Bashkimi Evropian paska një kryetar të përbashkët për të gjitha shtetet që e përbëjnë këtë Bashkim dhe një Ministri të përbashkët të Politikës së Jashtme për të gjitha këto vende, pse Shqipëria dhe Kosova të mos kenë një kryetar të përbashkët, një Ministri të Politikës së Jashtme të përbashkët dhe ambasada të përbashkëta në shtete të ndryshme në Botë?

Shqipëria e Kosova nuk u dashka të kenë as pas njëzet vjetësh e as kurrë, as kryetar të përbashkët, as Ministri të Jashtme të përbashkët e as ambasada të përbashkëta për hir të feudalizmit dhe të feudalëve tanë, për shkak të mungesës së qartëpamjes dhe për shkak të mungesës së vizionit largpamës të tyre e, më së shumti, për shkak të servilizimit ndaj vartësve!

Një të ardhme të tillë të Shqipërisë e të Kosovës shqiptarët jo vetëm se nuk u dashka të kenë, por as ta ëndërrojnë për arsye se një ardhmëri të tillë nuk e pranojnë, nuk e duan feudalët tanë, që po bëjnë dhe që do të vazhdojnë të bëjnë politikë feudale! Por, feudalizmin dhe feudalët populli shqiptar qe shumë vjet i ka çuar në arkivin e terratisur të historisë. Dhe do t'i çojë në atë arkiv sa herë të paraqiten në jetën tonë politike, kulturore e shoqërore në përgjithësi.

**(Vijon)**

# Prekazi, një krim serb i shekullit



Basri MUSMURATI

Para se të shkruaja këtë shkrim për publikim, kisha një dilemë, a duhet ta bëja një gjë të tillë, dhe në 20-vjetorin e masakrës së Prekazit të shqetësoj edhe një herë me këto rrëfime ata pak anëtarë të familjes Jashari që mbetën gjallë pas masakrës dhe këta të tjerët që lindën e po rriten pas këtij krimi makabër. Përkundër që nga dita e parë e sulmeve serbe mbi Jasharët, për këto krime serbe kam folur, dokumentuar, shkruar e informuar kudo që qe e mundshme në Kosovë e jashtë saj në kohën kur ndodhi krimi, megjithatë vendosa ta bëj publik këtë shkrim e të sqaroj besnikërisht atë që kam parë me sytë e mi. Familjes Jashari dhe familjarëve të të tjerëve të vrarë në këtë masakër, fillimisht u kërkoj ndjesë që po ua shprish ndjenjat e dhimbjes edhe kësaj here për të afërmit e tyre të dashur.

Në mëngjesin e 5 marsit të vitit 1998, në Kryesinë e LDK-së na njoftuan se në Prekazin e Poshtëm të Komunës së Skenderajt po dëgjoheshin të shtëna armësh nga të gjitha llojet. Këtë informatë e mora nga Gani Koci. Shpejt u mor vesh se policia dhe ushtria serbe kishin bërë rrethimin e plotë të pjesës më të madhe të Drenicës. Cak i sulmeve serbe ishte Prekazi i Poshtëm, gjegjësisht lagjja e Jasharëve, më konkretisht familja e Shaban Jasharit. Kjo familje kishte qenë cak i sulmeve serbe edhe më parë. Vinin lajme se ka shumë të vrarë, por pushteti serb nuk dha asnjë informatë zyrtare. Në zyrën e LDK-së nuk kishte ndonjë qarkullim të veçantë, me përjashtim të disa anëtarëve të Kryesisë. Pas orës 11.00 në seli erdhi edhe Ibrahim Rugova, kryetar i LDK-së. Menjëherë komunikuam, por ai tha se nuk kishte kurrfarë informatash. Rreth orës 13.00 rashë në kontakt sërish me Gani Kocin, Ramadan Dobrën e Idriz Rrecin, të cilët na informuan se në qytetin e Skenderajt nuk mund të depërtohet nga asnjë anë, por në Prekaz ka luftime pa ndalur. Sipas tyre, njerëzit që ishin të gatshëm t'u shkonin në ndihmë Jasharëve, nuk kishte mundësi as të afroheshin, sepse kishte izolim të plotë nga policia e ushtria serbe.

Para orës 14:00 të 5 marsit 1998 unë, Basri Musmurati, Rexhep Gjergji dhe shoferi Lulzim Makolli, u nisëm për të shkuar në Prekaz të Epërm nga drejtimi i Vushtrrisë. Pas një ndalese të shkurtër që na bëri policia në Pestovë të Vushtrrisë, pa ndonjë problem arritëm deri në fshatin Galicë. Aty takuam ca gazetarë që pritnin. Më vonë kuptuam se ndonjëri prej tyre kishte shkuar deri në Prekaz të Epërm, por ne nuk i takuam. Vlen të theksohet se te një pjesë e gazetarëve, ashtu edhe te një pjesë e opinionit të Kosovës, ishte formuar një përshtypje se anëtarët e kryesisë së LDK-së nuk i gjen gjë, se këta "I mbron Amerika", thoshin. E vërteta ishte krejt ndryshe, lëvizjet tona shpesh i paguanim me kurriz. Pasi lamë makinën në fshatin Galicë, u nisëm për Prekazin e Epërm. Ne nuk e dinim rrugën, por me ne erdhi një djalë i ri. Pasi udhëtuam, ndoshta gjysmë ore nëpër ara e male, arritëm në Prekaz të Epërm, në të cilin kisha qenë edhe më herët me Gani Kocin. Aty takuam shtatë veta që kishin ndezur një zjarr dhe vëzhgonin nga larg se çfarë po ndodhte në Prekazin e Poshtëm. Një nga ata mbante në krah një automatik të prodhimit rus, tjetri një pushkë M-48 me kondak të shkurtuar, i treti një pushkë gjuetie dhe një bombë dore, ndërsa të tjerët nuk kishin ndonjë armë të gjatë. Tre prej tyre i njihja, por emrat nuk ua dija. Vendi ku kishin ndezur zjarrin nuk ishte më larg se 1 500 metra vijë ajrore prej shtëpive të Jasharëve, prej të cilave dilte tym e flakë. Nëse isha orientuar deri diku, kjo pozitë nga dukej Lagjja e Jasharëve duhet të ketë qenë në pjesën juglindore të Prekazit të Epërm. Pasi u përshëndetëm, Rexhep Gjergji u tha atyre që hasëm: "A jeni normalë që qëndroni këtu? Me një granatë mund t'ju vrasin të gjithëve. Largohuni në pozicione më të përshtatshme". Njëri u përgjigj: "Jemi këtu kohë të gjatë, por nuk po na gjuajnë me armë". Megjithatë, bashkërisht u shpërndamë në pozicione prej nga mund të shihnim se çfarë po ndodhte. Dukeshin shtëpi të rrënuara, dukeshin policë serbë nga të gjitha anët. Çdo 4-5 minuta me gjyle topi goditej një shtëpi. Fillimisht shtëpinë e bombarduar e mbulonte tymi pastaj e kaplonte flakë. Më rrallë dëgjohej ndonjë e shtënë pushke, automatiku e pushkomitralozi. Nga se ne nuk ishim më larg se një kilometër e gjysmë në vijë ajrore nga lagjja Jashari, mund të shihnim shumë qartë gati çdo gjë e lëvizje. Nuk kishte lëvizje qytetarësh e lëvizjet e policisë serbe ishin më të rralla. As zhurmë e as britma qytetarësh nuk dëgjoheshin. Në një shtëpi në Prekazin e Epërm, diku afër shkollës, takuam një njeri që thanë se ka dalë nga rrethimi, por ai nuk ishte në gjendje të komunikonte me asnjeri, vetëm na shikonte i frikësuar, pa thënë asnjë fjalë të vetme. Shtëpitë e Prekazit të Epërm ishin të boshatisura plotësisht. Një pjesë e madhe e tyre ishin të shpuara nga plumba të pushkomitraloz?ve serbë. Nga ata pak banorë që takuam, njeri ishte shumë i shqetësuar dhe plot mllef, pse një predhë i kishte shpuar kovën e bunarit.

Në ndërkohë, një nga këta njerëz it e armatos, me një shqetësim, mu drejtua: "Duhet të largohemi pak nga këta se kam me të thanë diçka". Pasi u bind se nuk na dëgjon askush, vazhdoi: "Na kemi të dhëna se poshtë atje te Jashar?t janë 12 veta të vrarë në luftime dhe shumë të tjerë nuk mund të dalin nga rrethimi. Në mesin e të vrarëve është edhe Shaban Jashari, me gjasë edhe djali i tij, Hamza. Emrat e të tjerëve nuk i dimë saktësisht, por krejt janë të Jasharëve. Ne po presim të terrohet dhe do të futemi në front. Po t'i jap këto informata se nuk di çka do të bëhet kur të terrohet. Banorët e Prekazit të Epërm i kemi larguar porsa ka krisë lufta atje poshtë në Prekaz të Poshtëm". Sa bisedonim, granatimet nuk ndaleshin. Ishte për t'u çmendur kur dije se një lagje e tërë ishte në luftë me një makineri vrastare serbe dhe ti nuk mund të ndihmosh me asgjë. Thënia e këtyre burrave, se sa të terrohet edhe ne do të futemi në front, përveçse shprehte një gatishmëri të tyre për t'u sakrifikuar, dukej edhe si një utopi e këtyre njerëzve që nuk kishin farë armësh me të cilat mund të ndihmonin.

Kaluan më shumë se 45 minuta që ne po sorollateshim në kodrën e Prekazit të Epërm dhe nuk dinim ç'të bënim. Atij më të vjetrit që dukej më i pjekur dhe më i arsyeshëm në këtë kohë të paqartë, ata të tjerët i dëgjonin fjalët e tij, ne kërkuam nga një armë që të qëndronim edhe ne me ta gjatë natës. Një që nuk kishte fare armë, me një nervozë të jashtëzakonshme, na u përgjigj: "Na nuk po kemi një automat për vete e ju keni ardhur prej Prishtinës e lypni armë". Megjithatë, Rexhepi u tha: "Bëni çka të mundeni e të dini, por amanin jua kam mos e shpërndani luftën edhe këtu në Prekaz të Epërm dhe në fshatrat e tjerë ku ka fëmijë e gra".

Ishte ora 16:50 kur vendosëm të kthehemi në Prishtinë, së paku për të shpërndarë informata nëpër botë se çka po ndodhte në Drenicë. U ndamë nga ata pak njerëz që na shoqëruan gati një orë dhe vazhduam deri në Galic?, ku kishim makinën me të cilën duhej të ktheheshim në Prishtinë. Fatmirësisht, rrugës nuk patëm probleme.

Me të arritur në Prishtinë shkuam në Shoqatën e Shkrimtarëve, ku na pritnin gazetarë e ndonjë anëtar i Kryesisë së LDK-së. Një informatë me një disa fjali ia thamë Rasim Cubollit (të gjithë e thërrisnim Cima), i cili punonte me përkushtim për lansimin e informatave nëpër botë. Së pari me një faks informatat i përcillte në shumicën e ambasadave të huaja në Beograd, më pastaj ku arrinte nëpër adresa të ndryshme nëpër botë. Një kujdes të veçantë e kishim gjithherë me Shqipërinë, kur i dërgonim në Ambasadën e tyre në Beograd te Besnik Konqi, i ngarkuar me punë. Kur është fjala te zoti Konqi, vlen të thuhet se ai shumë shpesh vinte në Kosovë, herë duke i njoftuar organet gjegjëse në Beograd e më shumë vinte në vijë private. Ka qenë njeri shumë i përkushtuar për Kosovën ato vite sa qëndroi si diplomat në kryeqytetin e Serbisë, në Beograd. Me gazetarët që ishin tubuar në Shoqatën e Shkrimtarëve mbajtëm një konferencë shtypi duke i njoftuar se çka kishim parë në Prekaz. **(Vijon)**

# Artistët iniciojnë aktivitete për ta ndihmuar regjisorin Bekim Lumi

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Dhjetëra artistë ishin mbledhur të mërkurën në skenën e vogël të Teatrit Kombëtar të Kosovës, prej nga edhe kishin filluar të diskutojnë për aktivitetet e mëtutjeshme për të mbledhur fonde për ta ndihmuar regjisorin Bekim Lumi, i cili po përballet me sëmundjen e rëndë të kancerit.

Bekim Lumi tash e dy vjet po përballet me këtë sëmundje dhe trajtimi i tij i mëtutjeshëm mjekësor po bëhet i papërballueshëm për buxhetin familjar. Artistët kanë marrë një vendim që të mobilizohen dhe të solidarizohen me kolegun me të cilin kanë ndarë shumë nga përvoja e tyre.

Pas këtij takimi, Fatmir Spahiu, në një deklaratë për media, ka thënë se kjo iniciativë është bërë pa dijeninë e regjisorit Bekim Lumit. Ai ka treguar se në këtë mbledhje artistët diskutuan disa iniciativa për mbledhjen e fondeve. Spahiu ka theksuar se përmes aktivitete të planifikuara beson se do ta arrijnë vlerën që është e domosdoshme për regjisorin Lumi.

Personat të cilët duan ta ndihmojnë regjisorin Lumi mund t'i transferojnë mjetet e tyre në këto xhirollogari: Bartësi i kontos: Bekim Lumi. Adresa: Rr. "Theodor Muzaka", H. 1, Nr. 10, Prishtinë, 10000, RKS, Kosovë. Numri i kontos: 1110251567000198 Banka: ProCredit Bank Kosovo J.S.C.



E rrallë

## Nusja lë dhëndrin në altar pasi zbuloi se ishte tullac



Një nuse ka anuluar ceremoninë e dasmës pasi ka zbuluar gjatë ceremonisë se dhëndrit po i binin flokët. Kur dhëndëri hoqi nga koka kapelën e ceremonisë së dasmës, nusja u trondit sepse zbuloi se ai ishte tullac. Ajo refuzoi të martohej me të, duke shkaktuar kaos në ceremoninë martesore.

FOTO E DITES




Në fotografi shihet pamja e tregut gjatë natës në Bangkok të Tajlandës. /Reuters/

E jashtëzakonshme

## U godit nga një pemë në park, kërkon 200 milionë dollarë shpërblim



Një nënë e tre fëmijëve, e cila ka pësuar dëmtim kur u godit nga një pemë 1 360 kg në Parkun Qendror të Nju Jorkut, është duke përgatitur një padi prej 200 milionë dollarësh kundër qytetit. Anne Monoky ka pësuar lëndime të rënda pasi theu qafën derisa po ecte me djemtë e vet në park.

## BARSOLETA E DITËS



**- E dashura: Zemër, a e di sa ëndërroj të shkojmë për Muajin e Mjaltit në Hawai?**
**- I dashuri: A thua a kushton shtrenjtë?**
**- E dashura: Jo bre zemër, mos ke dert, se ëndrrat pa pare janë.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00**

### "FERDINAND" 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.
Regjia: Carlos Saldanha




**Në ora 18:00 dhe 20:00 (R)**

### "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.
Regjia: James Foley

**Në ora 22:00 (PG-13)**

### "THE COMMUTER"




Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Dita e sotme mund të ketë zhvillime që duhen konsideruar seriozisht nga ju. Nëse neglizhoni, do të shikoni që shumë shpejt do të gjendeni jashtë loje.



**DEMI**
Një projekt të ri nuk e keni marrë fare me entuziazëm dhe ata që ju njohin mirë e dinë se nuk do të arrini ta çoni deri në fund.



**BINJAKËT**
Keni ende dilema lidhur me një person dhe nuk do t'i zgjidhni derisa të arrini të diskutoni me një mik tuajin.



**GAFORRJA**
Nuk keni qenë shumë korrekt me një person afër jush që kërkon më tepër vëmendje nga sa i jepni. Mbase duhet t'i bëni gjërat të qarta.



**LUANI**
Nëse nuk jeni të kënaqur nga faktet e fundit, mbase bëni mirë të merrni një pozicion të qartë që gjithkush ta kuptojë mendimin tuaj.



**VIRGJËRESHA**
Mos merrni seriozisht fjalët e një personi që për momentin nuk arrin t'i arsyetojë ato, sepse është mjaft i ndikuar nga emocionet.



**PESHORJA**
Mbase keni ekzagjeruar me pretendimet e ditëve të fundit. Sot bëni një hap prapa dhe kërkoni falje tek personat që keni prekur.



**AKREPI**
Edhe pse instinkti juaj ju thotë krejt të kundërtën, veprimet që do të ndërmerrni janë të ndjekura nga arsyeja dhe logjika e ftohtë.



**SHIGJETARI**
Sot do ta zgjidhni rrugën me të shkurtër për të zgjidhur punë dhe për të mos pasur tepër shqetësime për vete.



**BRICJAPI**
Keni sjellë shumë gëzim në jetën e personave të caktuar dhe sot do të jetë dita kur do ta merrni mirënjohjen e tyre.



**UJORI**
Jeni tip i programuar dhe nuk ju pëlqejnë shumë surprizat. Sot do t'ju dalë çdo gjë jashtë kontrollit dhe dikush do t'ju bëjë një surprizë të bukur.



**PESHQIT**
Drejtojuni një personi të familjes sot për të marrë këshilla dhe do të shikoni që çdo gjë që do t'ju thotë do të këtë peshë tek ju.

# Rihanna, sportive dhe me stil



Këngëtarja me famë botërore, Rihanna, njihet për stilin unik. Ajo është shfaqur në aeroport me tuta sportive të cilat e shfaqën këngëtaren mjaft me stil. 30-vjeçarja duket se ka vendosur të vishet sa më komode gjatë fluturimit të saj për në Nju Jork.

# Charlize Theron thotë se i pëlqen të konsumojë bari



Aktorja 42-vjeçare Charlize Thero ka bërë me dije se shijon drogat psikoaktive më shumë se alkoolin. "Isha goxha në moshë kur e provova fillimisht marijuanën. Nuk kam provuar asgjë deri atëherë. Por me të vërtetë më pëlqeu më shumë se alkooli ose diçka tjetër", ka thënë Thero. Megjithatë, aktorja ka deklaruar se nuk ka përdorur më drogë, tash kur ka hyrë në të tridhjetat, pasi e ka kuptuar se e ka bërë atë të mërzitshme.



# Kim Kardashiani rikthehet në kohë

Kim Kardashiani ka vendosur të paraqitet më ndryshe teksa ka dalë në mbrëmje në Tokio. 37-vjeçarja është parë me veshje të fitnesit të viteve '80-ta, ku duket mjaft mirë dhe në formë. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe, ylli televiziv ka marrë gjithë vëmendjen.

# Jennifer Lawrence mohon lidhjen me Chris Prattin




Jennifer Lawrence dhe Chris Pratti nxitën thashetheme për një lidhje kur ata po punonin së bashku në filmin "Passengers" të vitit 2016. Tani aktorja 27-vjeçare ka sqaruar se ata nuk kishin asnjëherë diçka mes vete. "Unë kurrë s'kam qenë në lidhje me Chris Prattin", ka deklaruar Lawrence për "KISS FM".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Montim
Servisim
Porosi
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | |
|---|---|
| ALAVES - LEVANTE | 1 |
| LAS PALMAS - BARCELONA | 2 |
| MIDTJYLLAND - BRONDBY | GG3+ |

# Pjesëmarrja në 'PyeongChang 2018', e suksesshme

Besim Hasani dhe Milaim Kelmendi e kanë vlerësuar pozitive paraqitjen e skitarit Albin Tahiri në Lojërat Olimpike Dimërore, kurse Tahiri bëri me dije se ndihet krenar që është shqiptar. "Jam shumë i lumtur që isha në PyeongChang dhe e barta flamurin e Kosovës në ceremoninë hapëse të Lojërave Dimërore PyoengChang. Ishte kënaqësi ta përfaqësoj vendlindjen e babait tim, njëkohësisht vendin tim, sepse thellë në shpirtin tim ndihem shqiptar, edhe pse nuk e flas gjuhën shqipe aq mirë", ka thënë Tahiri




EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 SHKURT - Ekipi Olimpik që përfaqësoi Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore në "PyeongChang 2018" është rikthyer në Kosovë. Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) të mërkurën në një konference për medie kanë vlerësuar se pjesëmarrja në këto lojëra ishte e suksesshme.

Numri një i KOK-ut, Besim Hasani, ka vlerësuar se synimet e Kosovës janë arritur në Lojërat Olimpike Dimërore. "Albin Tahiri e ka radhitur Kosovën në mesin e shteteve pjesëmarrëse aq sa kanë qenë edhe pritshmëritë tona. Ngritja e flamurit në Fshatin Olimpik, ceremonia e hapjes dhe mbylljes solemne, takime të shumta me personalitete të larta të lëvizjes olimpike ndërkombëtare, ku veçohet ajo me presidentin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach, janë karakteristikat që e veçojnë paraqitjen e delegacionit të Kosovës në LOD PyeongChang 2018", ka thënë Hasani, duke shtuar: "Kosova ishte një nga nëntë vendet e licencuara për të qenë si pilot-projekt i Festivalit Olimpik PyeongChang 2018, që është mbajtur në nëntë vende të përzgjedhura në mesin e 209 shteteve olimpike. Mbi 8 000 fëmijë kanë praktikuar për herë të parë patinazhin dhe mbi 4 000 fëmijë kërlingun". Në këtë konferencë ka folur edhe sportisti i vetëm që e prezantoi Kosovën në "PyeongChang 2018". "Jam shumë i lumtur që isha në PyeongChang dhe e barta flamurin e Kosovës në ceremoninë hapëse të Lojërave Dimërore PyoengChang. Ishte kënaqësi ta përfaqësoj vendlindjen e babait tim, njëkohësisht vendin tim, sepse thellë në shpirtin tim ndihem shqiptar, edhe pse nuk e flas gjuhën shqipe aq mirë", ka thënë Tahiri. Ndërsa lidhur me paraqitjen e Tahirit në Lojërat Olimpike Dimërore foli edhe kryetari i Federatës Skitare të Kosovës (FSK), Milaim Kelmendi, i cili ka deklaruar: "Albin Tahiri ka lëvizur nga vendet 54, 37, që do të thotë se kjo është e mirë. Mbetet që në të ardhmen të punohet më shumë me të, por mendoj se është një rezultat i kënaqshëm".

## SHKURT

### Kompleksi sportiv 'Agron Rama' i jepet në shfrytëzim FFK-së

Në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Kastriotit, ndër pikat e rendit të ditës, ka qenë edhe kërkesa e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) për dhënien në shfrytëzim për 25 vjet të kompleksit sportiv "Agron Rama". Me 19 vota për dhe 2 abstenime, deputetët e Kuvendit Komunal miratuan këtë kërkesë, e cila do t'u hapë rrugë investimeve fillestare në vlerë prej 3 milionë eurosh. Pas aprovimit të kësaj kërkese, kryetari i komunës, Xhafer Gashi, u shpreh i kënaqur me këtë vendim dhe me investimin e UEFA-s që do të bëhet në këtë kompleks sportiv, veçanërisht e falënderoi kryetarin e FFK-së, Fadil Vokrri, për shtytjen që i ka dhënë këtij investimi kaq të rëndësishëm. Edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, që ishte i pranishëm në seancën e kuvendit, u nda i kënaqur me këtë vendim, njëkohësisht e falënderoi kryetarin e Komunës për angazhimin e tij të vazhdueshëm për tërheqjen e këtij investimi.

### Më 3 mars turniri i boksit "Thank You USA & Diaspora"

Më 3 mars në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë do të mbahet turniri i boksit "Thank You USA & Diaspora" i organizuar nga Klubi i Boksit "Prishtina". Pjesëmarrës në këtë turne pritet të jenë Shqipëria, Kosova, Gjermania, Kroacia, Bullgaria, Maqedonia dhe Mali i Zi, kurse turneu pritet të fillojë në orën 17:00.

### Kukësi - Skënderbeu, 2-2

Nën reshjet e dendura të dëborës, Kukësi dhe Skënderbeu ndanë nga një pikë në javën e 22-të të Kategorisë Superiore. Në "Zeqir Ymeri" u luajt me top të kuq supersfida e kësaj jave, e cila gjithsesi dhuroi emocione dhe plot katër gola. Për kampionët në fuqi golat u shënuan në pjesën e parë nga Kale dhe Donjet Shkodra, korçarët barazuan me dy gola të Soue. Ndeshja u zhvillua e gjitha në kushte të vështira për shkak të dëborës, e cila nuk pushoi përgjatë 90 minutave. Laçi fitoi 1-0 ndaj Vllaznisë, ndërkohë që surprizën e bëri Teuta, që mposhti 1-2 Kamzën në fushën e kësaj të fundit.

## Qeveria ndan parcelën për kompleksin sportiv



PRISHTINË, 28 SHKURT - Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim të mërkurën që të ndajë një parcelë të tokës në Bërnicë të Epërme për ta ndërtuar një kompleks sportiv. Projektin e këtij kompleksi e kanë bërë drejtuesit e FC Prishtinës, kurse do të kushtojë rreth 3.5 milionë euro. Ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi, para votimit, ka thënë se prishtinasit e meritojnë t'i jepet toka për ndërtimin e kompleksit sportiv. "Bazuar në kërkesën e klubit për marrjen në shfrytëzim të parcelës, 56 678 metrash katrorë (5.6 hektarë) në Bërnicë të Poshtme, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve sportive, kjo kërkesë për Ministrinë e Sportit është e arsyeshme, pasi me këtë rast talentet dhe futbollistët do të kenë ambiente të përshtatshëm. Dhënia e kësaj toke siguron kushte për zhvillimin e gjeneratave të reja, ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës, në veçanti avancimin e futbollit", ka thënë ministri Gashi.

## Queiroz: FIFA nuk duhet ta lejojë të luajë Messin

**Lisbonë, 28 shkurt** - Carlos Queiroz, trajneri i kombëtares së futbollit të Iranit, ka deklaruar se Cristiano Ronaldo është futbollisti më i mirë në botë, ndërsa Lionel Messi "nuk është njerëzor dhe për këtë arsye FIFA nuk duhet ta lejojë të luajë futboll". Trajneri portugez deklaroi për "fifa.com": "Gjithmonë them se Messi është i jashtëzakonshëm. Nuk është njerëzor. Derisa të provohet që është njeri, mendoj se FIFA nuk duhet ta lejojë të luajë. Queiroz do të përballet me Portugalinë e tij në fazën e grupeve të Botërorit dhe ish-trajneri i Manchester Unitedit dhe Real Madridit thotë se do të jetë një përballje e veçantë. "Do të kem kundërshtar Cristiano Ronaldon, më të mirin në botë. Por, në skuadër kam Ronaldot e mi që janë Jahan Bakhsh, Reza Goochannejad, Ali Karimi… Falë tyre besoj se do ta kalojmë grupin", deklaroi portugezi. Irani do të përballet me Spanjën, Portugalinë dhe Marokun në Grupin B të Botërorit.



# Shaqiri: Ky ka qenë sezoni më i mirë për mua

**Londër, 28 shkurt** - Reprezentuesi i Zvicrës, Xherdan Shaqiri, ka treguar arsyet e formës së tij të mirë me Stoke Cityn, ku në ndeshjet e fundit po shkëlqen duke shënuar edhe gola. Futbollisti shqiptar ka bërë me dije se kjo është meritë edhe e trajnerit të ri, Paul Lambert. "Nuk është sezoni më i mirë për Stoke, por si lojtar ju tentoni të bëni më të mirën për të dhuruar paraqitje të mira. Personalisht, ky ka qenë sezoni më i mirë për mua dhe jam i kënaqur me paraqitjet këtë edicion. Por, nuk jam i kënaqur me atë se si po shkon sezoni për ekipin", ka thënë Shaqiri, i cili më pas ka treguar edhe për dallimin në mes të Premierë Ligës, Serisë A dhe Bundesligës. "Kjo ligë është ndryshe nga Italia dhe Gjermania, pasi ju duhet të adaptoheni. Është viti im i tretë dhe mund të them se 'tani jam këtu' dhe se kam bërë shumë mirë. Në Premierë Ligë ju nevojitet kohë. Jam shumë i lumtur me paraqitjet e mija, por si ekip duhet të bëjmë më mirë", ka shtuar ai.




Lidhur me trajnerin Paul Lambert, Shaqiri ka deklaruar: "Ai ka mentalitet gjermani me ekipet e veta. Jam shumë i lumtur që ai erdhi këtu. Në ekipet gjermane ata gjithmonë hanë së bashku dhe nuk ka telefona në tavolinë. Kjo na ka bashkuar. Kur hani së bashku ju mund të flisni me shokët e ekipit me të cilët normalisht ju nuk flisni shumë. Është gjë e mirë. Ju dënoheni nëse merrni telefonin tuaj në darkë. Duhet t'i respektoni rregullat. Çdokush e respekton këtë - ekipi është më kompakt tani. Kjo është e rëndësishme për një ekip që tani ka nevojë për këtë. Jemi me vetëbesim dhe të lumtur".

# Clevelandi triumfoi ndaj Brooklynit, Milami mezi e mposhti Philadelphian

**Londër, 28 shkurt** - Reprezentuesi i Zvicrës, Xherdan Shaqiri, ka treguar arsyet e formës së tij të mirë me Stoke Cityn, ku në ndeshjet e fundit po shkëlqen duke shënuar edhe gola. Futbollisti shqiptar ka bërë me dije se kjo është meritë edhe e trajnerit të ri, Paul Lambert. "Nuk është sezoni më i mirë për Stoke, por si lojtar ju tentoni të bëni më të mirën për të dhuruar paraqitje të mira. Personalisht, ky ka qenë sezoni më i mirë për mua dhe jam i kënaqur me paraqitjet këtë edicion. Por, nuk jam i kënaqur me atë se si po shkon sezoni për ekipin", ka thënë Shaqiri, i cili më pas ka treguar edhe për dallimin në mes të Premierë Ligës, Serisë A dhe Bundesligës. "Kjo ligë është ndryshe nga Italia dhe Gjermania, pasi ju duhet të adaptoheni. Është viti im i tretë dhe mund të them se 'tani jam këtu' dhe se kam bërë shumë mirë. Në Premierë Ligë ju nevojitet kohë. Jam shumë i lumtur me paraqitjet e mija, por si ekip duhet të bëjmë më mirë", ka shtuar ai.




